



NJOFTIM PER MEDIA

Ditën e enjte, në datë 03.09.2015, ora 12.00 u zhvillua mbledhja e radhës e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve :

Z.Gentian Sala Kryetar

Z.Gledis Gjipali Anëtar

Z.Piro Misha Anëtar

Z.Zylyftar Bregu Anëtar

Pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës AMA vendosi:

- 1.Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Tv Ballkan” sh.a., për ndryshimin e emërimit (logos) së televizionit privat vendor nga “A1 Report” në “A1”.
- 2.Miratimin e kërkesës së shoqërisë Multiscreen” sh.p.k., për ndryshimin e emërimit (logos) së televizionit privat vendor nga “Albanian Screen” në “Report Tv”
- 3.Në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë së licencës dhe heqjen e licencës së tre subjekteve radiotelevizive, “Radio +2” sh.a., “Apollnet” sh.p.k., “Tring Tv” sh.a., AMA vendosi ti rrimarrë në shqyrtim në një kohë të dytë.
- 4.Mosdhënien e autorizimit, shoqërisë Deshيران Tv sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Deshيران Tv”.
- 5.Ndryshimin e zonës së ofrimin të shërbimit të shoqërisë Kl-Ed Kabëll” sh.p.k., autorizuar për subjektin televiziv privat kabllor Tv Kl-Ed”, nga qyteti Durrës deri në Plazhi Durrës”.

Në vijim AMA mori në shqyrtim ankimet administrative të subjekteve ndaj sanksioneve me gjobë dhe vendosi:

- 6.Të shfuqëzojë sanksionin me gjobë nr .16, datë 24.06.2015, në masën 1 000 000 (njëmilion) lekë, të vendosur ndaj shoqërisë “Abcom” sh.p.k., për subjektin kabllor “Abcom”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

7.Të shfuqëzohet sanksionin me gjobë nr. 21, datë 30.06.2015 të vendosur nga Grupi I Inspektimit, në masën 1 000 000 (njëmilion) lekë, ndaj personit fizik Fitim Goga, autorizuar për subjektin kabllor “Tv Goga”.

8.Të shfuqëzohet sanksionin me gjobë nr.23, datë 30.06.2015 të vendosur nga Grupi I Inspektimit, në masën 1 000 000 (njëmillion) lekë, ndaj shoqërisë Beqaj kabllor 2014 sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “Tv Beqaj”.

9. Ne lidhje me ankimin administrativ të Z. Krenar Avdulla, kundër sanksionit me gjobë nr. 1, datë 24.06.2015 të Grupit të Inspektimit , vendosur ndaj personit fizik Krenar Avdulla për subjektin kabllor “Tv Saranda Kabëll”, AMA vendosi shqyrtimin e ankimit në mbledhjen pasardhëse .

10.Të shfuqëzohet sanksionin me gjobë nr 19, datë 25.06.2015, të vendosur nga Grupi I Inspektimit në masën 1 000 000 (një million) lekë, ndaj shoqërisë Next Tv sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “Tv Next Kabëll”.

11.Lënien në fuqi të sanksionit me gjobë nr. 18, datë 25.06.2015 të vendosur nga Grupi I Inspektimit, në masën 1 000 000 (njëmilion) lekë, ndaj shoqërisë “Intelmedia” sh.p.k., për subjektin kabllor “Tv Jug”.

12.Të shfuqëzohet sanksionin me gjobë nr.22, datë 30.06.2015 të vendosur nga Grupi I Inspektimit, në masën 1 000 000 (një million) lekë, ndaj shoqërisë “Tv Kabllor Shijak” sh.p.k, për subjektin kabllor “Tv Shijak’.

Tiranë, më 03 Shtator 2015